



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2019

V E N D I M

Nr. 141, Datë 04/10/2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 31, datë 01.04.2019, e Z. F.Y., ku pretendohet diskriminim për shkak të “bindjes politike”, nga ana e Albpetrol sh.a.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur saj, rezulton se Z. F.Y. ka filluar punë në vitin 1979 pranë Shoqërisë Albpetrol sh.a., përkatësisht në Ndërmarrjen e Naftë-Sjellësit Patos. Ankuesi ka përfunduar Shkollën Teknike të Naftës në Ballsh përgjatë viteve 1971-1975, si dhe ka punuar për shumë vite në pozicione drejtuese në Sektorët e Naftës pranë kësaj shoqërie. Z. F.Y. informon se ka një ekperiencë 40 vjeçare në këtë fushë. Pozicioni i fundit, i punës, që ankuesi ka mbajtur pranë Albpetrol sh.a., ka qenë operator injektimi uji, pranë Q.P.N. Fier.

Nëpërmjet shkresës nr. 9358, datë 28.09.2018, së Albpetrol sh.a., ankuesi F.Y. është njoftuar për ndërprerjen të marrëdhënieve të punës me Albpetrol sh.a., për shkak të ristrukturimit të shoqërisë dhe në vijim nëpërmjet Vendimit nr. 1271, datë 31.12.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a.², atij i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me këtë shoqëri, si pasojë e shkurtimit të pozicionit të tij, të punës “operator injektimi uji”, në Sektorin e Prodhimit të Naftës Ballsh-Hekal, pranë Q.N.P. Fier.

¹Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

² Vendimi nr. 1271, datë 31.12.2018, i Administratorit të Albpetrol sh.a. përcaktonte si datë të përfundimit të marrëdhënieve financiare me ankuesin, datën 21.01.2019.

Për sa më sipër, ankuesi pretendon se ai i plotësonte të gjitha kriteret për të qëndruar në punë dhe për t'u mos përfshirë në ristrukturim, por Albpetrol sh.a. e ka larguar nga puna, për shkak të bindjeve të tij, politike, të djathta³.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proçeduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

A. Pas analizimit të ankesës nr. 31, datë 01.04.2019, e Z. F.Y., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*". Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi proçedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

B. Mbështetur në nenin 33, pika 7⁴, të ligjit nr. 10 221/2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Albpetrol sh.a., me shkresën nr. 460/2, datë 09.04.2019, ku kërkohet informacion, si më poshtë vijon:

- Kopje e kontratës së punës së ankuesit me Albpetrol sh.a.;
- Kopje e librezës së punës së ankuesit;
- Informacion, nëse ndaj ankuesit janë dhënë masa disiplinore gjatë periudhës, që ka punuar pranë Albpetrol sh.a.;
- Vlerësime për punën e kryer nga ankuesi ndër vite pranë Albpetrol sh.a.;
- Kopje e praktikës së përfshirjes së ankuesit në pushim kolektiv, ku të përfshihen:
- Njoftimi i Albpetrol sh.a. drejtuar ankuesit, për ndërprerje të marrëdhënieve të punës;
- Vendimi i Albpetrol sh.a. drejtuar ankuesit, për ndërprerje të marrëdhënieve të punës;
- Proçesverbalet e vlerësimit me pikëzim për Z. F.Y., si dhe të gjithë punonjësit, që kanë punuar në pozicionin e ankuesit pranë Sektorit Ballsh-Hekal, Q.N.P. Patos, Fier;
- Dokumentacioni i dosjes personale për të gjithë këta punonjësit e sipërpërmendur, përfshirë ankuesin.
- Numri i përgjithshëm i punonjësve të Q.N.P. Patos, Fier, që i janë nënshtruar pushimit kolektiv nga puna;
- Numri i përgjithshëm i punonjësve të Sektorit Ballsh-Hekal, pranë Q.N.P. Patos, Fier, që i janë nënshtruar pushimit kolektiv nga puna;
- Numri i pozicioneve "*operator injektimi uji*" pranë Sektorit Ballsh-Hekal, si dhe në tërësi pranë Q.N.P. Patos, Fier, që i është nënshkruar proçesit të ristrukturimit;

³ Referuar Librezës së Anëtarësisë Nr. 129880, lëshuar në datën 10.05.2007, nga Partia Demokratike e Shqipërisë, Dega Mallakastër, rezulton se Z. F.Y. është anëtar i kësaj force politike.

⁴ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: "*Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t'u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër*".

- Kopje e strukturës së mëparëshme dhe strukturës aktuale të Sektorit Ballsh-Hekal dhe Q.N.P. Patos, Fier.

1. Albpetrol sh.a. nuk i dërgoi përgjigje brenda afatit ligjor shkresës nr. 460/2, datë 09.04.2019, së Komisionerit.
2. Në vijim të ndjekjes së procedurave hetimore, si dhe në mungesë të informacionit të kërkuar nga Albpetrol sh.a., mbështetur në Urdhërin nr. 85, datë 03.05.2019, e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi *“Për kryerjen e inspektimit pranë Albpetrol sh.a., për verifikimin e pretendimeve të ankuesit F.Y., në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr. 31, datë 01.04.2019”*, inspektorët e KMD-së u paraqitën për inspektim pranë kësaj shoqërie.

Sipas informacionit të administruar, rezultoi se Z. F.Y. ka punuar pranë Albpetrol sh.a. prej vitit 1979. Z. F.Y. ka një eksperiencë pune 40 vjeçare pranë kësaj shoqërie. Pozicioni i fundit i punës, që ankuesi ka mbajtur pranë kësaj shoqërie ka qenë operator injektimi uji, pranë QPN Fier. Në muajin gusht 2018, QPN Fier dha vendburimin e naftës Ballsh-Hekal, një kompanie konçensionare (shqiptare) me kapital privat. Si rrjedhojë, QPN Fier pati shkurtim masiv të fuqisë punëtore. Kështu, nga 143 punonjës ekzistues, 120 të tillë iu nënshtruan pushimit kolektiv dhe kjo qendër aktualisht ka vetëm 23 punonjës. Të 4 (katër) pozicionet e punës *“operatorë injektimi uji”* pranë kësaj Qendre u suprimuan dhe punonjësit përkatës iu nënshtruan pushimit kolektiv. Nga 120 punonjës, vendi i punës së të cilëve u shkurtua, 88 punonjës u punësuan nga Konçensionari dhe 22⁵ të tjerë mbetën të papunë. Ankuesi nuk u punësua nga Konçensionari. Për sa i përket pushimit kolektiv, në të cilin u përfshi ankuesi, nuk është zbatuar procesi i vlerësimit me pikëzim, pasi të katër pozicionet e punës *“operator injektimi uji”* janë suprimuar.

Referuar kërkesave të Komisionerit në urdhërin e inspektimit, rezultoi se Albpetrol sh.a. nuk e dispononte librezën e punës së ankuesit, pasi ky i fundit e kishte tërhequr. Në mungesë të librezës së punës së ankuesit, inspektorët e KMD-së morën në administrim një kopje të fletës përkatëse të Regjistrat Themeltar të Punonjësve, ku rezultojnë të shënuara pozicionet e punës, që ankuesi ka mbajtur pranë kësaj shoqërie nga viti 1979, deri në vitin 2019. Sipas informacionit të dhënë nga specialistët e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Albpetrol sh.a., rezultoi se ankuesi ka marrë masa disiplinore, por këto masa janë të shuara. Shkresat përkatëse mbi këto masa, u ra dakord që, do të depozitohen me shkresë zyrtare nga kjo shoqëri pranë KMD-së. Albpetrol sh.a. dha në administrim të inspektorëve të KMD-së, shkresën nr. 596, datë 06.05.2019, të lëshuar nga Kryeinxhinieri Rr. C. Kjo shkresë u dha në cilësinë e vlerësimit në punë të ankuesit, pasi aktualisht, Z. Rr. C. është drejtor i komanduar i QPN Patos, Fier.

Strukturat përgjegjëse pranë Albpetrol sh.a. theksuan faktin se me strukturën ekzistuese të QPN Patos, nuk ka më pozicione pune *“operatorë injektimi uji”*. Inspektorët morën në administrim Procesverbalin nr. 810/5, datë 28.09.2018, ku rezultojnë 22 punonjës, që u prekën nga reduktimi i fuqisë punëtore. Në kushtet kur, më sipër u përmend fakti se 32 pozicione pune u shkurtuan, përfaqësuesit e Albpetrol sh.a. u shprehën se disa prej këtyre pozicioneve të punës ishin vakante. Referuar listës së mësipërme

⁵ 32 pozicione pune dhe 22 punonjës, pasi 10 pozicione pune ishin të paplotësuara me punonjës.

(në procesverbalin nr. 810/5, datë 28.09.2018) rezulton se bëjnë pjesë vetëm 2 ish-punonjës që dikur kanë punuar në pozicionin operator injektimi uji. Të pyetur për 2 ish-punonjësit e tjerë, që kanë punuar në të njëjtin pozicion pune, pranë QPN Patos, Fier, të cilët mbetën të papunë si rrjedhim i shkurtimit të pozicioneve të tyre të punës, përfaqësuesit e Albpetrol sh.a. u shprehën se njëri prej tyre ishte ri-punësuar në pozicionin e operatorit të prodhimit dhe punonte në QPN Patos (një ndër 23 punonjësit e mbetur pranë kësaj Qendre), ndërkohë që punonjësi tjetër ishte larguar më parë nga QPN Patos. Inspektorët e KMD-së kërkuan informacion të hollësishëm nga Albpetrol sh.a. mbi të katër operatorët e injektimit të ujit që punonin dikur pranë QPN Patos, aktet e largimit nga puna për dy operatorët e tjerë (përveç ankuesit), aktin e emërimit në detyrë të pozicionin “operator prodhimi” për atë punonjës që punon ende pranë këtij Sektori. Inspektorët kërkuan gjithashtu sqarime se mbi cilat kritere është mbështetur Albpetrol sh.a., që ka mbajtur në punë pranë QPN Patos njërin prej 4 operatorëve të injektimit të ujit, në pozicionin e operatorit të prodhimit, ndërkohë që 2 të tjerë i janë larguar nga puna. Për sa më sipër, u ra dakord që informacioni përkatës do të dërgohet zyrtarisht në adresë të KMD-së nga ana e Albpetrol sh.a. Inspektorët e KMD-së kërkuan që Albpetrol sh.a. të dërgojë zyrtarisht edhe një kopje të Aktmarrëveshjes së Albpetrol sh.a. me Koncesionarin.

3. Në vijim të inspektimit të kryer, Albpetrol sh.a. dërgoi shkresën nr. 3298/1, datë 14.05.2019, nëpërmjet së cilës informon se Z. F.Y. ka qenë punonjës i Shoqërisë “Albpetrol” sh.a. nga data 01.04.1979 deri në datën 01.01.2019 dhe së fundmi ka mbajtur pozicionin e punës “operator injektimi uji” pranë Qendrës së Prodhimit të Naftës, Fier.

Albpetrol sh.a. sqaron se në zbatim të Programit të Zhvillimit të Rishikuar për vitin 2018, i miratuar me Vendimin nr.14, datë 29.08.2018, të Këshillit Mbikqyrës, mbi ndryshimet strukturore në QPN Fier dhe reduktimin e fuqisë punëtore në Sektorin e Prodhimit Ballsh-Hekal, Shoqërisë “Anio Oil” sh.a., në zbatim të Marrëveshjeve Hidrokarbure, si dhe në vijim të procesit të ristrukturimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a., shoqëria ka ndërmarrë hapat për reduktimin e fuqisë punëtore në këtë sektor, si dhe në zbatim të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës nga punëdhënësi, ka njoftuar punëmarrësin Z. F.Y., me shkresën nr. 9358, datë 28.09.2018, për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit organizativ të shoqërisë.

Mbështetur në Vendimin nr. 14, datë 29.08.2018, të Këshillit Mbikqyrës të Albpetrol sh.a., si dhe në Vendimin nr. 596, datë 26.08.2018, të Administratorit të shoqërisë, struktura organizative e Sektorit Ballsh-Hekal, me dorëzimin e vendburimit, nga 143 vende pune bëhet 23 vende pune. Mbështetur në sa më sipër, Albpetrol sh.a. thekson faktin se procedura e ndjekur nga QPN Fier është konform legjislacionit në fuqi dhe urdhërave, që kanë dalë në zbatim të procesit të ristrukturimit të shoqërisë. Pozicioni i punës së Z. F.Y. është shkurtuar dhe për këtë arsye ai nuk i është nënshtruar procesit të vlerësimit dhe pikëzimit.

Ndërprerja e marrëdhënieve të punës me punonjësin F.Y., si pasojë e numrit të punonjësve të përfshirë në këtë proces ristrukturimi, në referencë të nenit 148, pika 1, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, nuk vlerësohet si pushim individual, por si pushim kolektiv. Kjo do të thotë se marrëdhënia punëdhënës-punëmarrës, pra raporti midis shoqërisë Albpetrol dhe Z. F.Y. nuk është

aspak individual dhe i lidhur me pretendimin e tij, se është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të bindjeve politike.

Albpetrol sh.a. thekson faktin se në kuptim të nenit 3, pikat 1 dhe 2, të Ligjit rr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në rastin konkret, zgjidhja e marrëdhënieve të punës ka ardhur për shkaqe objektive, që lidhen me punëdhënësin dhe aspak me punëmarrësin. Albpetrol sh.a. shprehet se të katër pozicionet e punës “operator injektimi uji” janë shkurtuar dhe në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një konkurs të punonjësve me profesion të njëjtë me Z. F.Y., në mënyrë që të kryhet edhe një përzgjedhje në bazë të kriterëve të vendosura nga punëdhënësi. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me trajtim të diferencuar në raport me njëri tjetrin të këtyre katër punonjësve.

Për sa i përket pretendimit të Z. F.Y. se është diskriminuar për shkak të bindjes politike, pasi është anëtar i subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë, Albpetrol sh.a. thekson se një pretendim i tillë është i pavërtetë, pasi kjo shoqëri nuk disponon të dhëna mbi përkatësinë politike të punonjësve të saj, por vetëm të dhënat personale bazë të tyre, për të cilat është marrë edhe miratimi i tyre me shkrim, sipas formularit përkatës. Në asnjë praktikë apo shkresë të punëdhënësit nuk është përmendur përkatësia politike e ndonjë prej punonjësve. Albpetrol sh.a. shprehet se punonjësi ka barrën e provës të provojë me prova shkresore, që shoqëria ka qenë zyrtarisht në dijeni të përkatësisë së tij politike, pasi është logjike që të diskriminosh dikë për shkak të bindjeve politike, duket që paraprakisht të kesh dijeni mbi këto bindje.

4. Në vijim të ndjekjes së procedurave të shqyrtimit administrativ, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 01.07.2019, ora 12:00, pranë Zyrës së KMD-së.

Albpetrol sh.a. iu kërkua që në këtë seancë të paraqesë informacionin e mëposhtëm:

1. Kopje e Akt-Marrëveshjes se Albpetrol sh.a. për dorëzimin e vendburimit të naftës Ballsh-Hekal;
2. Lista e punonjësve të vendburimit Ballsh-Hekal, të cilët janë punësuar nga Koncesionari – Shoqëria “Anio Oil” sh.a. Të përcaktohet autoriteti, që kreu përzgjedhjen e këtyre punonjësve;
3. Lista e punonjësve, të cilët mbetën të papunë si pasojë e dhënies së vendburimit Ballsh-Hekal dhe nuk u punësuan nga Koncesionari. Në këtë listë të reflektohen edhe pozicionet e punës, që këta punonjës kanë patur pranë Qendrës Ballsh-Hekal;
4. Referuar pikës 3, të jepet informacion, se cilët punonjës janë ri-sistemuar në vijim nga Albpetrol sh.a., pranë QPN Patos, Fier ose pranë ndonjë qendre tjetër të kësaj shoqërie;
5. Lista e punonjësve që kanë punuar në pozicionin “operator injektimi uji” pranë Qendrës së Prodhimit të Naftës Fier. Të jepet informacion i hollësishëm, lidhur me çështjet e mëposhtëme:
 - Cili prej individëve, që ka punuar në pozicionin e punës “operator injektimi uji”, në Qendrën Ballsh-Hekal, pranë QPN Patos, i është nënshtuar shkurtimit të pozicionit të punës, si pasojë e dhënies së vendburimit të naftës Ballsh-Hekal, Koncesionarit - Shoqërisë “Anio Oil” sh.a.?

- Cili prej tyre në vijim është punësuar nga ana e Koncesionarit - Shoqërisë “Anio Oil” sh.a?
 - Cili prej tyre është ri-punësuar nga Albpetrol sh.a. pranë QPN Patos, ose pranë ndonjë Qendre tjetër të kësaj shoqërie. Në rastin konkret të jepet informacion mbi emërtesën e pozicionit të punës, në të cilin është sistemuar punonjësi/t, si dhe të të sqarohet se mbi cilat kritere është mbështetur Albpetrol sh.a. për kryerjen e kësaj përzgjedhjeje në ri-punësimin përkatës.
6. Kopje të dosjeve personale të ish-punonjësve, që kanë punuar në pozicionin e operatorëve të injektimit të ujit, në Qendrën Ballsh-Hekal, pranë QPN Patos, Fier;
 7. Kopje të të gjithë strukturave organike të QPN Patos, Fier/Qendrës Ballsh-Hekal, nga data 01.01.2018 e në vijim.

Në seancë dëgjimore mori pjesë ankuesi F.Y. dhe përfaqësuesja e Albpetrol sh.a., që depozitoi aktin e përfaqësimit, përkatësisht aktin Prokurë Përfaqësimi nr. 6108, date 27.06.2019, të lëshuar nga Administratori i Albpetrol sh.a. Përfaqësuesja e Albpetrol sh.a. dorëzoi vetëm një kopje të Akt-Marrëveshjes se Albpetrol sh.a. për dorëzimin e vendburimit të naftës Ballsh-Hekal. Gjatë seancës dëgjimore u ra dakord që dokumentacioni ende i padorëzuar, do të dërgohej nga Albpetrol sh.a. në adresë të KMD-së, brenda datës 10 korrik 2019.

Në seancë dëgjimore, ankuesi F.Y. parashtroi sërisht pretendimet e tij për diskriminim për shkak të bindjes politike. Fillimisht, Z. F.Y. bëri një përmbledhje të historikut të tij të punësimit pranë Albpetrol sh.a. Ai informoi se është punësuar pranë Albpetrol sh.a. në vitin 1979 dhe që nga dt.17.12.2015 ka mbajtur pozicionin operator injektimi uji pranë Albpetrol sh.a. Z. F.Y. u shpreh se ka një eksperiencë të gjatë, 40 vjeçare në fushën e naftës dhe për këtë arsye nuk duhej larguar nga puna. Ai u shpreh se arsyeja, për të cilën i është zgjidhur kontrata e punës nga ana e Albpetrol sh.a., është e lidhur me bindjet e tij politike, që i përkasin kahut të djathtë. Ankuesi u shpreh se i përkiste edhe kategorisë së ish-të përndjekurve politike. Përfaqësuesit e Komisionerit i kërkuan të depozitonte dokumentacionin provues në lidhje me këtë fakt në vijim të seancës dëgjimore⁶. I pyetur gjatë seancës, nëse Albpetrol sh.a. i ka larguar nëpërmjet ristrukturimit, të gjithë punonjësit e tij që kanë bindje të djathta, ankuesi u përgjigj se një pjesë e tyre janë ende të punësuar pranë kësaj shoqërie, por pjesa më e madhe e tyre është larguar nga puna. Ankuesi theksoi faktin se Sektori Ballsh-Hekal ka patur 4 (katër) pozicione pune “operator injektimi uji”, të cilat janë suprimuar. Si pasojë e suprimimit të tyre, 2 punonjës janë përfshirë në pushim kolektiv, ndërkohë që njëri prej tyre i quajtur A. I. është sistemuar në pozicionin operator prodhimi, pranë QPN Patos dhe nuk është përfshirë në pushim kolektiv. I pyetur nëse në vijim ka depozituar kërkesë për ripunësim pranë Albpetrol sh.a., ankuesi u shpreh se nuk ka depozituar asnjë kërkesë për t’u ripunësuar pranë kësaj shoqërie.

Përfaqësuesja e Albpetrol sh.a. u shpreh se ndaj Z. Myrtaj janë zbatuar të gjitha procedurat ligjore për zgjidhjen e kontratës së punës, si pasojë e përfshirjes në pushim kolektiv. Z. Myrtaj nuk iu nënshtrua vlerësimit me pikëzim, pasi pozicioni i tij i punës u shkurtua, sikurse edhe të

⁶ Në vijim të seancës dëgjimore, ankuesi nuk e dorëzoi dokumentacionin përkatës, që provonte faktin se ai i përket shtresës së ish-të përndjekurve politikë.

gjithë pozicionet e “operatorëve të ujit”, pranë QPN Patos. Përfaqësuesit të Albpetrol sh.a. iu kërkua të dërgonte, brenda datës 10.07.2019, pranë KMD-së, informacionin e kërkuar në njoftimin për seancë dëgjimore, i cili nuk u depozitua në këtë seancë, pavarësisht kërkesës në njoftimin për seancë dëgjimore. Përfaqësuesja e Albpetrol sh.a. theksoi faktin se zgjidhja e kontratës së punës, si pasojë e ristrukturimit të shoqërisë dhe zbatimit të pushimit kolektiv, nuk ka lidhje me bindjen politike të ankuesit, pasi kjo shoqëri nuk ka dijeni mbi bindjet politike të punonjësve të saj dhe në dosjet e punonjësve të saj nuk disponohet asnjë dokument, që vërteton bindjet e tyre politike.

5. Në vijim, Komisioneri mbajti korrespondencë nëpërmjet postës elektronike me Albpetrol sh.a. lidhur me depozitim të akteve të mësipërme. Në datën 15.07.2019, Albpetrol sh.a. dërgoi disa prej akteve të kërkuara.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuses.

Z. F.Y. ka qenë punonjës i Shoqërisë “Albpetrol” sh.a. nga data 01.04.1979 deri në datën 01.01.2019 dhe së fundmi ka mbajtur pozicionin e punës “operator injektimi uji” pranë Qendrës së Prodhimit të Naftës, Fier.

Në zbatim të Programit të Zhvillimit të Rishikuar për vitin 2018, i miratuar me Vendimin nr.14, datë 29.08.2018, të Këshillit Mbikqyrës, mbi ndryshimet strukturore në QPN Fier dhe reduktimin e fuqisë punëtore në Sektorin e Prodhimit Ballsh-Hekal, Shoqërisë “Anio Oil” sh.a., në zbatim të Marrëveshjeve Hidrokarbure, si dhe në vijim të procesit të ristrukturimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a., Albpetrol sh.a. ka ndërmarrë hapat për reduktimin e fuqisë punëtore në këtë sektor. Mbështetur në Vendimin nr. 14, datë 29.08.2018, të Këshillit Mbikëqyrës të Albpetrol sh.a., si dhe në Vendimin nr. 596, datë 26.08.2018, të Administratorit të shoqërisë, struktura organizative e Qendrës së Prodhimit të Naftës fier nga 406 punonjës bëhet 286 punonjës. Në vijim, struktura e Sektorit Ballsh-Hekal, si pjesë e kësaj qendre, me dorëzimin e vendburimit të naftës nga 143 vende pune bëhet 23 vende pune.

Referuar dokumentacionit të depozituar nga Albpetrol sh.a. në cilësinë e provës rezulton se pas dorëzimit të vendburimit të naftës, 88 ish-punonjës të Sektorit Ballsh-Hekal u punësuan nga Koncesionari, Shoqëria “Anio Oil” sh.a.. Referuar nenit 10, pika 10.1, të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Ballsh-Hekal”⁷ së lidhur në datën 19.07.2007, ndërmjet Albpetrol sh.a. dhe Stream Oil & Gas Limited⁸ citohet: “Kontraktori do të zgjedhë ekipin drejtues të tij dhe punonjësit sipas përzgjedhjes së tij, dhe do të përcaktojë kushtet e

⁷ Në vijim të kësaj Marrëveshjeje është nënshkruar Instrumenti i Transferimit ndërmjet Albpetrol sh.a., AKBN dhe Shoqërisë “Anio Oil & Gas”, ku kjo e fundit ka blerë të drejtat e lindura nga kjo Marrëveshje Hidrokarbure;

⁸ Aktualisht kjo shoqëri emërtohet “Transatlantic Albania LTD”, me nr. Nipt. K72205016P

punësimin dhe numrin e punonjësve, që do të përdoret për Operacionet Hidrokarbure. Sidoqoftë, Kontraktori dhe Nënkontraktorët e tij, do të punësojnë, në masën e mundur, shqiptarë të kualifikuar për kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure, duke i dhënë prioritet personelit të Albpetrolit, nëse aftësitë profesionale, njohja dhe ekspertiza e tyre përputhet me kërkesat operacionale.....”. Në këtë kontekst, rezulton se përzgjedha e 88 punonjësve të Sektorit Ballsh-Hekal është kryer nga vete Konçesionari.

Ndërkohë që, mbështetur në dokumentacionin e depozituar nga Albpetrol sh.a. rezulton se 22 punonjës të këtij sektori iu nënshtruan pushimit kolektiv, sikurse edhe ankuesi. Referuar nenit 15, pika 15.1.6, të Kontratës Individuale të Punës së lidhur ndërmjet ankuesit F.Y. dhe Albpetrol sh.a. përcaktohet shprehimisht: *“Kontrata Individuale e punës do të zgjidhet në këto raste:.....Kur shoqëria i nënshtrohet procesit të ristrukturimit. Në rast se Punëmarrësi del pa punë si pasojë e ristrukturimit të shoqërisë, që lidhet me dorëzimin e puseve dhe/ose vendburimeve të Albpetrol sh.a. një shoqërie tjetër në bazë dhe për zbatim të një Marrëveshjeje Hidrokarbure, ekzistuese apo që do të lidhet në të ardhmen, do të zbatohen kërkesat e nenit 138, pika 3 e Kodit të Punës....”*. Në mbështetje të dispozitave ligjore, si dhe Kontratës Individuale të Punës, Albpetrol sh.a. ka njoftuar punëmarrësin Z. F.Y., me shkresën nr. 9358, datë 28.09.2018, për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, për shkak të ristrukturimit organizativ të shoqërisë dhe në vijim, nëpërmjet Vendimit nr. 1271, datë 31.12.2018, kjo shoqëri ka kryer ndërprerjen e marrëdhëneve të punës me ankuesin.⁹

Në strukturën aktuale të miratuar nga Administratori i Shoqërisë, përcjellë Qendrës së Prodhimit të Naftës Fier, nëpërmjet shkresës nr. 9150, datë 25.09.2018, rezulton se në këtë Qendër bëjnë pjesë 23 pozicione pune. Sipas kësaj strukture rezulton se nuk ka pozicione pune *“operator injektimi uji*, të cilët në referencë të strukturës paraardhëse rezulton se janë suprimuar. Referuar dokumentacionit të depozituar nga Albpetrol sh.a. rezulton se dy prej punonjësve, që punonin në këto pozicione pune i janë nënshtruar pushimit kolektiv, njëri prej pozicioneve ishte vakant dhe punonjësi i tretë A. I., nuk i është nënshtruar pushimit kolektiv, por nëpërmjet shkresës nr. 797, datë 25.09.2018, ai është emëruar operator prodhimi¹⁰ në Depo nr. 7, të Gr. 7 në Sektorin Ballsh-Hekal.

Për sa më sipër, Komisioneri vë në dukje faktin se nga 3 (tre) punonjës, që punonin në pozicionet *“operator injektimi uji”* pranë Sektorit Ballsh-Hekal, 2 (dy) të tillë i janë nënshtruar pushimit kolektiv, ndërkohë që punonjësi A. I. është transferuar në një pozicion tjetër pune, i cili nuk i është nënshtruar suprimimit. Komisioneri konstatoi gjithashtu se transferimi i Z. A. I. është kryer zyrtarisht në datën 25.09.2018, pikërisht 3 ditë para se kolegut të tij, që punonte në pozicion analoge me të, i është dërguar shkresa nr. 9358, datë 28.09.2018, nëpërmjet së cilës njoftohej për ndërprerje të marrëdhënieve të punës. Trajtimin e pabarabartë me kolegun e transferuar në një pozicion pune tjetër pranë Sektorit Ballsh-Hekal, që nuk prekej nga pushimi kolektiv, Albpetrol sh.a. e ka justifikuar duke depozituar në cilësi prove shkresën nr. 596, datë 06.05.2019, me lëndë: *“Vlerësim pune për punonjës të F.Y.”*, lëshuar nga Kryeinxhinier Rr. Ç., ku citohet: *“Gjatë kohës së ushtrimit të detyrës në ish-QPN Ballsh nga Z. F.Y. është konstatuar konkretisht: Mungesa e disiplinës në punë: Nuk ka zbatuar me përpikmëri orarin zyrtar të punës; Nuk ka respektuar rregullat dhe etikën profesionale*

⁹ Referuar vendimit në fjalë, marrëdhëniet financiare me ankuesin ndërpritën në datën 21.01.2019.

¹⁰ Zëri “operator prodhimi” ekziston në strukturën aktuale të Sektorit Ballsh Hekal. Referuar kësaj strukture, në të bëjnë pjesë 14 pozicione “operatorë prodhimi”;

gjat orarit të punës. Mungesë të rezultateve dhe performancës në punë: Nuk ka kryer me korrektësi detyrat funksionale që i janë ngarkuar”. Por, pavarësisht sa më sipër, Albpetrol sh.a. nuk ka depozituar në cilësi prove vlerësimet e punës për dy punonjësit e tjerë, që kanë punuar në pozicione pune të njëjta me Z. F.Y., e sidomos vlerësimin e punës për Z. A. I., i cili punon ende pranë Sektorit Ballsh-Hekal, në pozicionin e operatorit të prodhimit.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se pavarësisht se ndodhemi në kushtet kur, zgjidhja e kontratës individuale të punës me ankuesin F.Y., ka ndodhur si pasojë e zbatimit të pushimit kolektiv, në kuadër të ristrukturimit të Sektorit Ballsh-Hekal, si rezultat i dorëzimit të vendburimit të naftës shoqërisë konçensionare, ankuesi është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë, me punonjës të tjerë të këtij Sektori, nga ana e Albpetrol sh.a. Një përfundim i tillë rezultoi nga analiza e mësipërme, pasi Z. A.I., i cili ndodhej në të njëjtat kushte me Z. F.Y., nuk iu nënshtrua pushimit kolektiv, por përkundrazi u transferua në një pozicion tjetër pune pranë të njëjtit Sektor.

A. Shkaku i mbrojtur.

Në ankesën nr. 31, datë 01.04.2019, e Z. F.Y., pretendohet diskriminim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Albpetrol sh.a.

“Bindja politike”, “është njëri prej shkaqeve, për të cilët, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “bindjes politike”, Komisioneri gjykon se “bindja politike” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme¹¹, që e justifikojnë si të tillë.

B. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se Z. F.Y. i është nënshtruar një qendrimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë në krahasim me punonjës të tjerë, të Sektorit Ballsh-Hekal, që ndodheshin në kushte të njëjta me të, nga ana e Albpetrol sh.a.

¹¹ Referuar Librezës së Anëtarësisë Nr. 129880, lëshuar në datën 10.05.2007, nga Partia Demokratike e Shqipërisë, Dega Mallakastër, rezulton se Z. F.Y. është anëtar i kësaj force politike.

Sikurse rezulton edhe nga rubrika paraardhëse, Z. F.Y. i është nënshtruar pushimit kolektiv, për shkak të ristrukturimit të Sektorit Ballsh-Hekal, si pasojë e dorëzimit të vendburimeve të naftës një shoqërie koncesionare, ndërkohë që kolegu i tij, që punonte në të njëjtin pozicion pune, Z. A. I. është transferuar nga Administratori i Albpetrol sh.a., vetëm pak ditë nga fillimi i procedurave për pushim kolektiv, në një pozicion tjetër pune (që nuk u suprimua) brenda të njëjtit Sektor.

Për sa më sipër, Komisioneri ka konstatuar një trajtim të pabarabartë ndërmjet dy individëve që ndodhen në kushte të njëjta, ndërkohë që Albpetrol sh.a., i cili në bazë të nenit 82, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar)¹², ka patur barrën e provës për të provuar se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të disfavorshme dhe të pabarabartë, për shkak të bindjeve politike, nuk e ka kryer një gjë të tillë.

Gjatë hetimit administrativ, Komisioneri kërkoi nga Albpetrol sh.a., të dispononte kopje të plota të dosjeve personale të të tre ish-operatorëve të injektimit të ujit pranë Sektorit Ballsh-Hekal, ku të rezultonte i gjithë dokumentacioni i një dosjeje të rregullt pune, që administrohet nga struktura përkatëse e burimeve njerëzore. Për sa më sipër, Albpetrol sh.a. depozitoi dosje të mangëta dhe nuk dërgoi pranë KMD-së, asnjë dokument apo akt administrativ, që të justifikonte faktin e transferimit të Z. A. I. nga operator injektimi uji, në operator prodhimi pranë të njëjtit sektor, vetëm disa ditë para fillimit të procedurave për pushim kolektiv të dy punonjësve të tjerë, që punonin në të njëjtat pozicione pune. Njëkohësisht, Albpetrol sh.a. depozitoi një vlerësim pune të viti 2019, për Z. F.Y., por nuk depozitoi vlerësimet e punës për 2 punonjësit e tjerë, në mënyrë që Komisioneri të evidentonte treguesit e performancës, si dhe të kryente një krahasim të performancës në punë ndërmjet dy operatorëve të injektimit të ujit, që iu nënshtruan pushimit kolektiv dhe Z. A. I., i cili ende punon pranë Sektorit Ballsh-Hekal. Për sa më sipër, mos dhënia e argumentimit përkatës nga ana e Albpetrol sh.a., në lidhje me lëvizjen e Z. A. I. në pozicionin e operatorit të prodhimit, ndërkohë që ankuesi iu nënshtrua pushimit kolektiv, si dhe mos dërgimi i informacionit të plotë, lidhur me dosjet e ish-punonjësve “operatorë injektimi uji” pranë Sektorit Ballsh-Hekal, pavarësisht insistimit të Komisionerit, krijon dyshimin e arsyeshëm që Z. F.Y. diskriminohet për shkak të bindjes së tij politike.

Për sa më sipër, parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit parashikohet nga Kushtetura e Republikës së Shqipërisë, si dhe nga akte të tjera ligjore, duke sanksionuar njëkohësisht edhe zbatimin e tij nga të gjithë shtetasit shqiptarë. Referuar nenit 49, të Kushtetutës së Republikës parashikohet: *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*. Në këtë sens, kjo dispozitë i garanton çdo individ të drejtën për punë.

¹² Neni 82, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) parashikon: *“2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. 3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t’i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme.”*

Njëkohësisht, në referencë të nenit 14 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut garantohet barazia e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, sikurse edhe në Kartën Social Europiane (të rishikuar) dhe shtojcën e saj përkatësisht në nenin 24, pika 3, gërma d) parashikohet shprehimisht: “...Nuk do të përbëjnë arsye të vlefshme për përfundimin e punësimit....d) raca, ngjyra, gjinia, gjendja familjare përgjegjësitë familjare, shtatëzania, besimi fetar, opinion politik, prejardhja kombëtare ose origjina sociale”.

Referuar vendimit të Gjykatës Europiane të Drejtësisë¹³, për çështjen *Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar* (2012), duke u mbështetur në parimin e tij të nenit 11, të KEDNJ-së, që partitë politike janë thelbësore për funksionimin e duhur të demokracisë, Gjykata konsideron: “Duke pasur parasysh rëndësinë e demokracisë në sistemin e Konventave, Gjykata konsideron se në mungesë të masave mbrojtëse gjyqësore një sistem juridik i cili lejon largimin nga puna vetëm për shkak të anëtarësimit të punonjësve në një parti politike mbart me vete mundësinë e abuzimit” (paragrafi 55).

Në nenin 9, të Kodit të Punës është parashikuar: “Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”. Ndërkohë që në pikën 5, gërma c), të këtij neni parashikohet se: “Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me: ...c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”.

Parashikimi i mësipërm është hartuar në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të Ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet, në bazë të së cilave ndaj një individi mund të ketë diskriminim. Nëpërmjet parashikimit të nenit 12, të ligjit të sipërpërmendur ndalohet diskriminimi, në lidhje me të drejtën për punësim, për shkaqet e parashikuara në nenin 1 të këtij ligji. Neni 12, pika 1, gërma c) i këtij ligji parashikon shprehimisht: “1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Referuar nenit 3, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, diskriminimi përkufizohet si: ““Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të

13. Redfearn v The United Kingdom: ECHR 6 Nov 2012

drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se Shoqëria Albpetrol nuk ka depozituar prova, fakte dhe argumentime bindëse, nëpërmjet së cilave të provohej e kundërta e pretendimeve të ankuesit F.Y.. Në këto kushte KMD, çmon se ankuesi është diskriminuar për shkak të bindjes politike.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, të Z. F.Y., për shkak të bindjes politike, nga Albpetrol sh.a.
2. Në referencë të pikës 1 të këtij Vendimi, Albpetrol sh.a. të marrë masa të menjëherëshme, për punësimin e Z. F.Y. në një pozicion pune brenda kësaj shoqërie.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë Vendim, Albpetrol sh.a. të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha - punësim
Shkak – bindja politike